Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 2 (dy) persona me profesion shofer, OE paraqet në staf 2 (dy) punonjës, të cilët jo domosdoshmërisht janë të regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer, por që disponon lejen e drejtimi perkatese dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të artikujve ushqimore, brenda afatëve të ekzekutimit të kontratës.

Per punonjesit qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

***Shenim:** Kriteri nr.4 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

***Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyres se mallrave që kërkohen të prokurohen sic jane ushqime per institucione te tjera eshte e nevojshme pasja e nje stafi te kualifikuar. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar ne nevojën per realizimin e kontrates së furnizimeve të mallrave qe kerkohen.*

5.Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standardet respektive në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë OE duhet të paraqesë vetëdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i kryer nga autoritetet përkatëse në subjektin e tij, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Për OE/BOE vendas:

Vetdeklarimi duhet të përmbajë datën dhe numrin e procesverbalit të kontrollit të fundit të AKU.

Për OE/BOE e huaj:

Vetdeklarimi i paraqitur për plotësimin e këtij kriteri duhet të përshkruaj qartësisht:

institucionin që ka ushtruar kontrollin përkatës në vendin e origjinës dhe website-in zyrtar të institucionit;

datën e lëshimit të këtij dokumentacioni;

Ky dokumentacion duhet të paraqitet, i noterizuar dhe i certifikuar me vulë “Apostile”.

***Shenim:** Kriteri nr.5 konsiderohet i permbushur me plotesimin e deklarates. Dokumenti i kerkuara me siper do te paraqitet ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Për OE/BOE e huaj:

OE i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ka për detyrim të paraqesë dokumentacionin provues, ku të provohet se nga kontrolli i fundit i institucionit përkatës në vendin e origjinës, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore, si dhe dokumentacionin provues të kontrollit të institucionit përkatës në periudhën e vetedeklarimit.

Ky dokumentacion duhet të paraqitet, i noterizuar dhe i certifikuar me vulë “Apostile

***Argumentimi:** Në bazë të nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar dhe rekomandimit të përmbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Nisur nga objekti i prokurimit, furnizme me ushqime, eshte e rendesishme qe operoret ekonomik te jene vleresuar nga organtet kompetente qe e ushtrojne aktivitetin e tyre konform legjislacionit te fushes, kjo per te rritur sigurine ushqimore.*

6.Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) stabiliment, ne zbatim të nenit 19 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”. Për të provuar këtë kriter duhet të paraqesë dokumentet:

- a) Certifikatë pronësie ose kontratë noteriale qiraje/perdorimi të vlefshme, për stabilimentin.
- b) Licencën e kategorisë “II.1.A.1 dhe Licencë të kategorisë “II.1.B , për stabilimentin që ka paraqitur dokumentet sipas gërmës “a” të këtij kriteri.

Ne rast te konstatimit te ushtrimit te stabilimentit jo ne perputhje me kete nen do te referohen prane AKU per ndjekjen e procedurave perkatese administrative sipas nenin 68 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar nenit 40, pika 5 , gërma ç) dhe pika 8 e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar; Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë; VKM nr.538, date 26.05.2009 ”Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetarre te Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa” te ndryshuar; nenit 19 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë ambientet/stabilimentet dhe licencat perkatese per keto stabilimente, për kryerjen e furnizimit objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomik duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambjentet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjenes dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit. Kërkesa per minimalisht 1 stabiliment është një kërkesë minimale qe i krijon siguri autoritetit kontraktor se operatori ekonomik ka jo vetem pajisjet por edhe amjentet e pershtatshme per realizimin me sukses dhe ne vazhdimesi te kontrates.

7.Operatori ekonomik duhet të deklarojë sipas tabelës 1 nëse është **prodhues**. Nëse operatori ekonomik është **tregtues** duhet të deklarojë sipas tabelës 2, kontratat e furnizimit të lidhura me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga prodhuesi, për artikujt objekt prokurimi.

Tabela 1. Forma e deklarimit për operatorin ekonomik që paraqitet si prodhues i mallit.

Nr.	Emertimi i artikullit	Prodhues. Të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website
1		
2		
Etj.,		

Tabela 2. Forma e deklarimit për operatorin ekonomik që paraqitet si tregtues i autorizuar nga prodhuesi ose distributor i autorizuar nga prodhuesi.

Nr.	Emertimi i artikullit	Prodhuesi/Distributori i autorizuar Të dhëna të plota si: telefon, fax, e-mail, website	Data e fillimit të kontratës se furnizimit	Data e perfundimit te kontratës se furnizimit
1				
2				
Etj.,				

Shenim: Kriteri nr.7 konsiderohet i permbushur me plotesimin e vetëdeklarimit, sipas tabelës së mësipërme. Kontratat e furnizimit të kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë edhe dokumenta të tjera të cilat i konsideron të rëndësishme për objektin. Duke qënë se kemi të bëjmë me furnizime me ushqime, kërkohet siguri se operatori ekonomik ka mundësi të furnizojë në mënyrë të vazhdueshme dhe sipas kërkesës dhe afatit të caktuar nga autoriteti kontraktor, si në rastin kur është prodhues ashtu edhe në rastin kur nuk është prodhues i produktit.

8.Operatorët ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesin **-Raport/Fletë Analizë Fiziko-Kimike dhe Raport/ Fletë Analizë Mikrobiologjike**, të lëshuar nga një laborator i referencës ose i akredituar sipas legjislacionit në fuqi. Të cilat të jenë të lëshuara brenda 30 (tridhjetë) ditëve, para datës së hapjes së ofertave. Këto **Raport/Fletë Analiza** duhet të paraqiten origjinale, ose fotokopje të noterizuara, dhe të ngarkohen në SPE:

- Për të gjithë artikujt objekt prokurimi : **“Blerje bulmet dhe nënproduktet e tij.”**

Argumentim: Kjo kërkesë është vendosur me qëllim që OE të vërtetojë se artikujt objekt prokurimi plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara

9.Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (pika 1 të seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

Argumentim: Kërkesa që OE duhet të provojë se disponon kapacitetet financiare, ekonomike dhe teknike për realizimin e të gjitha loteve ku ka ofertuar është bazuar në nenin 42, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, gjithashtu kjo kërkesë i referohet rekomandimit të APP nr. 6732 prot., datë 21.10.2020, ku përcaktohet që nëse OE ofertojnë në më shumë se një lot, duhet ti provojnë AK se disponojnë aftësitë teknike dhe gjendjen ekonomike /financiare për realizimin e të gjitha objekteve të loteve ku kanë marrë pjesë në ato shpallen fitues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

LOTIN III. "BLERJE BUKË INTEGRALE + BUKË THEKRE",
Fondi Limit: 4,176,000 (katër milion e shtatëqind e njëzetë e nëntë mijë e nëntëqind e trembëdhjetë) lekë pa T.V.SH.

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë, **Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”** të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar nenit 40, pika 5, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar; Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë; VKM nr.538, date 26.05.2009 ”Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetarre te Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa” te ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e furnizimit objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomik duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambientet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjenës dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.

1.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vleres se përllorarit** e lotit (fondi limit i lotit).

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; neni 42 pika 3 dhe nenin 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të

Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të këtij është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku përcaktohet se; Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar, ku vlera e fondit limit të këtij loti është nën vlerën e kufirit të ulët monetar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit, për realizimin e kontratës me sukses.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.

Argumentimi: Në bazë të nenit 40 pika 5/ç të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se kanë kapacitetet teknike për ekzekutimin e kontratës, pra operatorët ekonomik duhet të vërtetojnë që kanë mjetet e duhura për ushtrimin e veprimtarisë, i cili duhet të funksionojë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi duke paraqitur një deklaratë.

3. Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 1 (një) automjet ATP (jo frigorifer), per transportin e mallrave, të cilin duhet t'a ketë në pronësi /qira/huapërdorje.

Për sa me sipër operatori ekonomik te vetedeklaroje sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				pronësi /qira/huapërdorje.

Shenim:

Per mjetin e kërkuar duhet të paraqiten dokumentat si më poshtë:

- Për mjetin në pronësi të paraqitet çertifikata e pronësisë, librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve.
- Për mjetin me status qira/huapërdorje të disponohet kontrata noteriale perkatëse e vlefshme, librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve.

Per mjetet qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Shenim: Kriteri nr.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kërkuara me sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e transportit të ushqimëve për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor, duke marrë parasysh vlerën llojin e objektit të prokurimit për këtë lot, numrin dhe shpërndarjen gjeografike të autoriteteve kontraktore që do të furnizohen e konsideron si një kriter minimal dhe të drejtë kërkesën për një automjet për zbatimin e kontrates.

4. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës, per te realizuar shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer	1
Punetore te thjeshte	1
Total	2

- Per punonjesit e punesuar shofer të paraqitet kontrate pune dhe leje drejtimi përkatëse.
- Per punonjesit e punesuar punetore te thjeshte të paraqitet vetem kontrate pune.

Shenim:

Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 (një) person me profesion shofer, OE paraqet në staf 1 (një) punonjës, i cili jo domosdoshmërisht është i regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer, por që disponon lejen e drejtimi perkatëse dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të artikujve ushqimorë, brenda afatëve të ekzekutimit të kontratës.

Per punonjesit qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Shenim: Kriteri nr.4 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyres se mallrave që kërkohen të prokurohen sic jane ushqime per institucione te tjera eshte e nevojshme pasja e nje stafi te kualifikuar. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar ne nevojen per realizimin e kontrates së furnizimeve të mallrave qe kerkohen.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqese një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetëdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitetet konform kërkesave ligjore.

Shenim: Kriteri nr.5 konsiderohet i permbushur me plotesimin e deklarates. Dokumenti i kerkuara me siper do te paraqitet ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar dhe rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Nisur nga objekti i prokurimit, furnizime me ushqime, eshte e rendesishme qe operoret ekonomik te jene vleresuar nga organtet kompetente qe e ushtrojne aktivitetin e tyre konform legjislacionit te fushes, kjo per te rritur sigurine ushqimore.

6. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) stabiliment, ne zbatim të nenit 19 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”.

Për të provuar këtë kriter duhet të paraqesë dokumentet:

- a) Çertifikatë pronarie ose kontratë noteriale qiraje/perdorimi të vlefshme, për stabilimentin.
- b) Licencen e kategorisë “II.1.A.1, për stabilimentin që ka paraqitur dokumentet sipas gërmës “a” të këtij kriteri.

Ne rast te konstatimit te ushtrimit te stabilimentit jo ne perputhje me kete nen do te referohen prane AKU per ndjekjen e procedurave perkatese administrative sipas nenin 68 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar nenit 40, pika 5, gërma ç) dhe pika 8 e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar; Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë; VKM nr.538, date 26.05.2009 ”Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetarre te Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa” te ndryshuar; nenit 19 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë ambientet/stabilimentet dhe licencat perkatese per keto stabilimente, për kryerjen e furnizimit objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomik duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambjentet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjens dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit. Kërkesa per minimalisht

1 stabiliment është një kërkesë minimale që i krijon siguri autoritetit kontraktor se operatori ekonomik ka jo vetëm pajisjet por edhe amjentet e pershtatshme për realizimin me sukses dhe në vazhdimësi të kontrates.

7. Operatori ekonomik duhet të deklarojë sipas tabelës 1 nëse është **prodhues**. Nëse operatori ekonomik është **tregtues** duhet të deklarohet sipas tabelës 2, kontratat e furnizimit të lidhura me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga prodhuesi, për artikujt objekt prokurimi.

Tabela 1. Forma e deklaramit për operatorin ekonomik që paraqitet si prodhues i mallit.

Nr.	Emertimi i artikullit	Prodhues. Të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website
1		
2		
Etj.,		

Tabela 2. Forma e deklaramit për operatorin ekonomik që paraqitet si tregtues i autorizuar nga prodhuesi ose distributor i autorizuar nga prodhuesi.

Nr.	Emertimi i artikullit	Prodhuesi/Distributori i autorizuar Të dhëna të plota si: telefon, fax, e-mail, website	Data e fillimit të kontratës së furnizimit	Data e përfundimit të kontratës së furnizimit
1				
2				
Etj.,				

***Shenim:** Kriteri nr.7 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e vetëdeklarimit, sipas tabelës së mësipërme. Kontratat e furnizimit të kërkuara me sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, për përparësi publikimit të njoftimit të fituesit dhe nëse afatet e ankimit ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor.*

***Argumentimi:** Në bazë të nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë edhe dokumenta të tjera të cilat i konsideron të rëndësishme për objektin. Duke qënë se kemi të bëjmë me furnizime me ushqime, kërkohet siguri se operatori ekonomik ka mundësi të furnizojë në mënyrë të vazhdueshme dhe sipas kërkesës dhe afatit të caktuar nga autoriteti kontraktor, si në rastin kur është prodhues ashtu edhe në rastin kur nuk është prodhues i produktit.*

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (pika 1 të seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

- 8.OE duhet të paraqesë dëshmitë të testimeve zyrtare sipas kërkesave në specifikimet

teknike, për secilin prej artikujve objekt i këtij loti.

Argumentim: *Kjo kërkesë është vendosur me qëllim që OE të vërtetojë se artikujt objekt prokurimi plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara*

9.Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (pika 1 të seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

Argumentim: *Kërkesa që OE duhet të provojë se disponon kapacitetet financiare, ekonomike dhe teknike për realizimin e të gjitha loteve ku ka ofertuar është bazuar në nenin 42, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, gjithashtu kjo kërkesë i referohet rekomandimit të APP nr. 6732 prot., datë 21.10.2020, ku përcaktohet që nëse OE ofertojnë në më shumë se një lot, duhet ti provojnë AK se disponojnë aftësitë teknike dhe gjendjen ekonomike /financiare për realizimin e të gjitha objekteve të loteve ku kanë marrë pjesë nëse ato shpallen fitues.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

LOTI IV “BLERJE FRUTA-PERIME ”

Fondi Limit: 13,002,900 (trembëdhjetë milion e dy mijë e nëntëqind) lekë pa T.V.SH

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRZGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”**, në emër të tij, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Per kete arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesemarrës duhet te jete i licensuar sipas dispozitave perkatese ligjore dhe nen ligjore).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar nenit 40, pika 5 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar; Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë; VKM nr.538, date 26.05.2009 ”Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetarre te Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa” te ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e furnizimit objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomik duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambjentet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjenes dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.

1.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 1.Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare, **2021, 2022, 2023** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e lotit (fondi limit i lotit).

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ato i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të Operatorëve Ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, u përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitetin sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

1.4 Kapaciteti teknik:

1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së perlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së perlllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 40, pika 4e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së perlllogaritur të kontrates, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.Operatori ekonomik duhet të paraqes **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.

Argumentimi: Në bazë të nenit 40 pika 5/ç të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se kanë kapacitetet teknike për ekzekutimin e kontratës, pra operatorët ekonomik duhet të vërtetojnë që kanë mjetet e duhura për ushtrimin e veprimtarisë, i cili duhet të funksionojë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi duke paraqitur nje deklaratë.

3.Operatori ekonomik duhet të disponojë **të paktën 1 (një)** automjete ATV (frigorifer), për transportin e mallrave, të cilin duhet t’i ketë në pronësi /qira/huapërdorje.

Për sa me sipër operatori ekonomik te vetedeklaroje sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtës	Statusi
1				pronësi /qira/huapërdorje.

Shënim:

Per mjetin e kërkuar duhet të paraqiten dokumentat si më poshtë:

- Për mjetin në pronësi të paraqitet çertifikata e pronësisë, librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve.
- Për mjetin me status qira/huapërdorje të disponohet kontrata noteriale perkatese e vlefshme, librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve.

Per mjetin qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Shënim: Kriteri nr.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kërkuara me sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e transportit të ushqimeve për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor, duke marrë parasysh vlerën llojin e objektit të prokurimit për këtë lot, numrin dhe shpërndarjen gjeografike të autoriteteve kontraktore që do të furnizohen e konsideron si një kriter minimal dhe të drejtë kërkesën për një automjet për zbatimin e kontrates.

4.5.Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës, për të realizuar shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer	1
Punetore të thjeshtë	1
Total	2

- Për punonjësit e punësuar shofer të paraqitet kontrate pune dhe leje drejtimi përkatëse.
- Për punonjësit e punësuar punetore të thjeshtë të paraqitet vetëm kontrate pune.

Shënim:

Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 (një) person me profesion shofer, OE paraqet në staf 1 (një) punonjës, i cili jo domosdoshmërisht është i regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer, por që disponon lejen e drejtimi përkatëse dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të artikujve ushqimore, brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

Per punonjesit qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Shënim: Kriteri nr.4 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kërkuara me sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyrës së mallrave që kërkohen të prokurohen sic janë ushqime për institucione të tjera është e nevojshme pasja e një stafi të kualifikuar. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar në nevojën për realizimin e kontratës së furnizimeve të mallrave që kërkohen.

5.Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Shënim: Kriteri nr.5 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e deklaratës. Dokumenti i kërkuara me sipër do të paraqitet në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar dhe rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Nisur nga objekti i prokurimit, furnizime me ushqime, është e rëndësishme që operatorët ekonomik të jenë vlerësuar nga organet kompetente që e ushtrjnë aktivitetin e tyre konform legjislacionit të fushës, kjo për të rritur sigurinë ushqimore.

6.Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) stabiliment, në zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”. Për të provuar këtë kriter duhet të paraqesë dokumentet:

- a) Çertifikatë pronësie ose kontratë noteriale qiraje/perdorimi të vlefshme, për stabilimentin.

- b) Licencen e kategorisë II.1.A.1, për stabilimentin që ka paraqitur dokumentet sipas gjermës “a” të këtij kriteri.

Ne rast të konstatimit të ushtrimit të stabilimentit jo në përputhje me këto nën do të referohen pranë AKU për ndjekjen e procedurave perkatase administrative sipas nenin 68 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar nenit 40, pika 5, gjërma ç) dhe pika 8 e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar; Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë; VKM nr.538, datë 26.05.2009 ”Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nenligjore të perbashketa” te ndryshuar; nenit 19 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë ambientet/stabilimentet dhe licencat perkatase për këto stabilimente, për kryerjen e furnizimit objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomik duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambientet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjenes dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit. Kërkesa për minimalisht 1 stabiliment është një kërkesë minimale që i krijon siguri autoritetit kontraktor se operatori ekonomik ka jo vetëm pajisjet por edhe amjentet e pershtatshme për realizimin me sukses dhe në vazhdimësi të kontratës.

7.Operatori ekonomik duhet të deklarojë sipas tabelës 1 nëse është **prodhues**. Nëse operatori ekonomik është **tregtues** duhet të deklarohet sipas tabelës 2, kontratat e furnizimit të lidhura me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga prodhuesi, për artikujt objekt prokurimi.

Tabela 1. Forma e deklaramit për operatorin ekonomik që paraqitet si prodhues i mallit.

Nr.	Emertimi i artikullit	Prodhues. Të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, �ebsite
1		
2		
Etj.,		

Tabela 2. Forma e deklaramit për operatorin ekonomik që paraqitet si tregtues i autorizuar nga prodhuesi ose distributor i autorizuar nga prodhuesi.

Nr.	Emertimi i artikullit	Prodhuesi/Distributori i autorizuar Të dhëna të plota si: telefon, fax, e-mail, website	Data e fillimit të kontratës së furnizimit	Data e p�erfundimit të kontratës së furnizimit
1				
2				
Etj.,				

Shenim: Kriteri nr.7 konsiderohet i p ermbushur me plotesimin e vet edeklarimit, sipas tabelës së mësipërme. Kontratat e furnizimit të kerkuara me sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë edhe dokumenta të tjera të cilat i konsideron të rëndësishme për objektin. Duke qënë se kemi të bëjmë me furnizime me ushqime, kërkohet siguri se operatori ekonomik ka mundësi të furnizojë në mënyrë të vazhdueshme dhe sipas kërkesës dhe afatit të caktuar nga autoriteti kontraktor, si në rastin kur është prodhues ashtu edhe në rastin kur nuk është prodhues i produktit.

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (pika 1 të seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

LOTI V " BLERJE PRODUKTE USHQIMORE "

Fondi limit : **8,121,067** (tetë milion e njëqind e njëzet e një mijë e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa T.V.SH

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”**, në emër të tij, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (*nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Per kete arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesemarrës duhet te jete i licensuar sipas dispozitave perkatese ligjore dhe nen ligjore*).

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar nenit 40, pika 5 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar; Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë; VKM*

nr.538, date 26.05.2009 "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetarre te Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa" te ndryshuar. Me ane te ketij kriteri kerkohej qe operatoret ekonomike te deshmojne se disponojne licencat profesionale per kryerjen e furnizimit objekt i kontrates, te leshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomik duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 "Për ushqimin" i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambientet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjenes dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; neni 42 pika 3 dhe nenin 43 pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" te ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: "Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata". Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit te këtij është brenda kufirit të përcaktuar ne nenin 43 pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" te ndryshuar, ku përcaktohet se "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: b) vlerën e përlogaritur të kontrates ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20 % e vlerës së përlogaritur të kontrates, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses.

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.

Argumentimi: Në bazë të nenit 40 pika 5/ç të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se kanë kapacitetet teknike për ekzekutimin e kontratës, pra operatorët ekonomik duhet të vërtetojnë që kanë mjetet e duhura për ushtrimin e veprimtarisë, i cili duhet të funksionojë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi duke paraqitur nje deklarate.

3. Operatori ekonomik duhet të disponojë **të paktën 1 (një)** automjet ATP (jo frigorifer), për transportin e mallrave, të cilin duhet t’ a ketë në pronësi /qira/huaperdorje.

Për sa me sipër operatori ekonomik te vetedeklaroje sipas formatit te mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtës	Statusi
1				pronësi /qira/huaperdorje.

Shenim:

Per mjetin e kërkuar duhet të paraqiten dokumentat si më poshtë:

- Për mjetin në pronësi të paraqitet certifikata e pronësisë, librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve.
- Për mjetin me status qira/huaperdorje të disponohet kontrata noteriale perkatese e vlefshme, librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve.

Per mjetet qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Shenim: Kriteri nr.3 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me sipër do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e transportit të ushqimeve për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor, duke marrë parasysh vlerën llojin e objektit të prokurimit për këtë lot, numrin dhe shpërndarjen gjeografike të autoriteteve kontraktore që do të furnizohen e konsideron si një kriter minimal dhe të drejtë kërkesën për nje automjet për zbatimin e kontrates.

4. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës, për të realizuar shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer	1
Punetore të thjeshtë	1
Total	2

- Për punonjësit e punësuar shofer të paraqitet kontrate pune dhe leje drejtimi përkatëse.
- Për punonjësit e punësuar punetore të thjeshtë të paraqitet vetëm kontrate pune.

Shënim:

Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 (një) person me profesion shofer, OE paraqet në staf 1 (një) punonjës, i cili jo domosdoshmërisht është i regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer, por që disponon lejen e drejtimi përkatëse dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të artikujve ushqimore, brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

Per punonjesit qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Shënim: Kriteri nr.4 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyrës së mallrave që kërkohen të prokurohen sic janë ushqime për institucione të tjera është e nevojshme pasja e një stafi të kualifikuar. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar në nevojën për realizimin e kontratës së furnizimeve të mallrave që kërkohen.

5. Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standardet respektive në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë OE duhet të paraqesë vetëdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i kryer nga autoritetet përkatëse në subjektin e tij, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Për OE/BOE vendas:

Vetedeklarimi duhet të përmbajë datën dhe numrin e procesverbalit të kontrollit të fundit të AKU.

Për OE/BOE e huaj:

Vetedeklarimi i paraqitur për plotësimin e këtij kriteri duhet të përshkruaj qartësisht:

institucionin që ka ushtruar kontrollin përkatës në vendin e origjinës dhe website-in zyrtar të institucionit;

datën e lëshimit të këtij dokumentacioni;

Ky dokumentacion duhet të paraqitet, i noterizuar dhe i certifikuar me vulë “Apostile”.

- *Shënim: Kriteri nr.5 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e deklaratës. Dokumenti i kerkuara me sipër do të paraqitet në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Për OE/BOE e huaj:

OE i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ka për detyrim të paraqesë dokumentacionin provues, ku të provohet se nga kontrolli i fundit i institucionit përkatës në vendin e

originës, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore, si dhe dokumentacionin provues të kontrollit të institucionit përkatës në periudhën e vetdeklarimit.

Ky dokumentacion duhet të paraqitet, i noterizuar dhe i certifikuar me vulë "Apostile

Argumentimi: Në bazë të nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar dhe rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Nisur nga objekti i prokurimit, furnizime me ushqime, është e rëndësishme që operatorët ekonomik të jene vlerësuar nga organtet kompetente që e ushtrojnë aktivitetin e tyre konform legjislacionit të fushes, kjo për të rritur sigurinë ushqimore.

6.Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) stabiliment, ne zbatim të nenit 19 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 "Per ushqimin".

Për të provuar këtë kriter duhet të paraqesë dokumentet:

- a) Çertifikatë pronësie ose kontratë noteriale qiraje/perdorimi të vlefshme, për stabilimentin.
- b) Licencen e kategorisë "II.1.A.1, për stabilimentin që ka paraqitur dokumentet sipas gërmës "a" të këtij kriteri.

Ne rast te konstatimit te ushtrimit te stabilimentit jo ne perputhje me kete nen do te referohen prane AKU per ndjekjen e procedurave perkatese administrative sipas nenin 68 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 "Per ushqimin".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", te ndryshuar nenit 40, pika 5 , gërma ç) dhe pika 8 e VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" te ndryshuar; Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë; VKM nr.538, date 26.05.2009 "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetarre te Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa" te ndryshuar; nenit 19 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 "Per ushqimin" Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë ambientet/stabilimentet dhe licencat perkatese per keto stabilimente, për kryerjen e furnizimit objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomik duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 "Për ushqimin" i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambientet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjenës dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit. Kërkesa per minimalisht 1 stabiliment është një kërkesë minimale qe i krijon siguri autoritetit kontraktor se operatori ekonomik ka jo vetem pajisjet por edhe amjentet e pershtatshme per realizimin me sukses dhe ne vazhdimesi te kontrates.

7.Operatori ekonomik duhet të deklarojë sipas tabelës 1 nëse është **prodhues**. Nëse operatori ekonomik është **tregtues** duhet të deklarojë sipas tabelës 2, kontratat e furnizimit të lidhura me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga prodhuesi, për artikujt objekt prokurimi.

Tabela 1. Forma e deklarimit për operatorin ekonomik që paraqitet si prodhues i mallit.

Nr.	Emertimi i artikullit	Prodhues. Të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite
1		
2		
Etj.,		

Tabela 2. Forma e deklaramit për operatorin ekonomik që paraqitet si tregtues i autorizuar nga prodhuesi ose distributor i autorizuar nga prodhuesi.

Nr.	Emertimi i artikullit	Prodhuesi/Distributori i autorizuar Të dhëna të plota të si: telefon, fax, e-mail, website	Data e fillimit të kontratës se furnizimit	Data e perfundimit te kontratës se furnizimit
1				
2				
Etj.,				

***Shenim:** Kriteri nr.6 konsiderohet i permbushur me plotesimin e vetëdeklarimit, sipas tabelës së mësipërme. Kontratat e furnizimit të kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

***Argumentimi:** Në bazë të nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë edhe dokumenta të tjera të cilat i konsideron të rëndësishme për objektin. Duke qënë se kemi të bëjmë me furnizime me ushqime, kërkohet siguri se operatori ekonomik ka mundësi të furnizojë në mënyrë të vazhdueshme dhe sipas kërkesës dhe afatit të caktuar nga autoriteti kontraktor, si në rastin kur është prodhues ashtu edhe në rastin kur nuk është prodhues i produktit.*

8. OE duhet të paraqesë dëshmitë të testimeve zyrtare sipas kërkesave në specifikimet teknike, për secilin prej artikujve objekt i këtij loti.

Argumentim: Kjo kërkesë është vendosur me qëllim që OE të vërtetojë se artikujt objekt prokurimi plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara.

9. Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (pika 1 të seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

Argumentim: Kërkesa që OE duhet të provojë se disponon kapacitetet financiare, ekonomike dhe teknike për realizimin e të gjitha loteve ku ka ofertuar është bazuar në nenin 42, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, gjithashtu kjo kërkesë i referohet rekomandimit të APP nr. 6732 prot., datë 21.10.2020, ku përcaktohet që nëse OE ofertojnë në më shumë se një lot, duhet ti provojnë AK se disponojnë aftësitë teknike dhe gjendjen ekonomike /financiare për realizimin e të gjitha objekteve të loteve ku kanë marrë pjesë në ato shpallen fitues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

○ Për hartimin e specifikimeve teknike është patur parasysh, natyra e përdorimit të produkteve ushqimore si produkte ushqimor në përbërje të menusë së miratuar me Urdhërit nr. 76/1, datë 24.01.2018 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”, dhe Urdhërit nr. 457, datë 13.06.2018, Për një ndryshim të Urdhrit nr. 76/1, datë 24.01.2018 “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”, Hartimi i specifikimeve teknike, nga ana e Komisionit, është kryer duke iu referuar:

- Standardeve Shtetërore në fuqi STASH, respektivisht për çdo artikull.
- Bazuar në Ligjin Nr.9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr.9441, datë 11.11.2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr.10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr.87/2012 për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 16.8.2012, të këshillit të ministrave “Për përcaktimin e rregullave për thejjen e kafshëve dhe tregëtimin e mishit të tyre”.
- Bazuar në Ligjin Nr.87/2013, “Për kategorizimin e prodhimit, emërtimin dhe tregëtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsisë së ullirit” dhe Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 235, datë 21.3.2017 Për miratimin e rregullores “Për karakteristikat e cilësisë dhe kriteret e natyrshmërisë së vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit”.
- Udhëzimi Nr.2 datë 13.01.2021 “Për vendosjen e rregullave të hollësishme në lidhje me standardet e marketimit dhe tregëtimin të vezëve”, në udhëzimin Nr.21 datë 25.11.2010 të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
- Udhëzimin e Ministrisë së Bujqësisë Nr 15 dt. 09.09. 2021 “Mbi kritret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.
- Ligji Nr.9942, datë 26.6.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut” i ndryshuar.
- Vendimin Nr.434, datë 11.7.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”
- Udhëzimi Nr.207 datë 31.3.2015 “Për përcaktimin e treguesve të cilësisë dhe sigurisë së miellit të grurit të parapaketuar për t’u shitur tek konsumatori i fundit ose për prodhimin e produkteve të tjera ushqimore”.

Specifikimet teknike të përgjithshme të artikujve ushqimorë, kanë të përcaktuara karakteristikat, treguesit fiziko-kimikë dhe shqisorë, kërkesat cilësore, ambalazhimin dhe etiketimin e artikujve, kushtet e ruajtjes dhe transportit duke pasqyruar saktë dhe në mënyrë të plotë, kërkesat e

Autoriteteve Kontraktore referuar gjendjes së tregut. Specifikimet teknike janë hartuar me qëllim që të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë Autoritetet Kontraktore dhe Operatorët Ekonomikë. Specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emri të veçantë, patente, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi.

➤

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Për hartimin e specifikimeve teknike për objektin e prokurimit njesia e prokurimit është referuar specifikimeve teknike të unifikuara nga Drejtoria e Standartizimit dhe janë në përputhje me perçkatimet ligjore në fuqi dhe janë pjese e pandare e DST.

